



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:257228

Datë: 20.08.2024

Numri i dokumentit: 06066198

C.nr.1056/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Hatixhe Begaj, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësit M.K.nga fshati B., Komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, ndaj të paditurës Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) me seli në Prishtinë, adresa MASHT- II, sipas bazës juridike kompensim i mjeteve mbi bazën e kualifikimit/licencimit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 20.08.2024 muar këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.K.nga fshati B., Komuna e Malishevës, ashtu që **DETYROHET** e paditura Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) që në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit/licencimit, t'ia paguaj paditësit për periudhën 11.11.2018 deri më 31.12.2021 (paga bazë 459.00 € * 35% i pagës bazë (160.65 € - 82.55 diferencë e paguar në page = 78.10 €) x 38 muaj gjithsej $38 * 78.10 = 2,967.80$ €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt. 11.11.2021, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar, konkretisht shuma prej 12.54 euro.

III. DETYROHET e paditura që paditësit pjesërisht t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 20.00 euro, ndërsa **REFUZOHET** pjesa tjetër e shpenzimeve të paditësit në emër precizimit të padisë shumën prej 104.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi M.K.nga fshati B., Komuna e Malishevës përmes të autorizuarit të tij Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, në këtë gjykate ka parashtruar padi ndaj të paditurës Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) me seli në Prishtinë, sipas bazës juridike kompenzim i mjeteve mbi bazën e kualifikimit/licencimit, sipas padisë mësimdhënësi është i punësuar në Qendrën e Kompetencës “K.K.” në Malishevë, dhe i cili ka 15 vite përvojë pune, e cila dëshmohet edhe përmes kontratës së punës dhe vërtetimit dhe listës së pagës, i punësuar ka paraqitur kërkesë për pagimin e diferencës sipas kulaifikimit, nga gjykata ka kërkuar të aprovet padia si e bazuar.

I autorizuari i paditësit përmes parashtrësës së datës 15.05.2024 ka bërë precizimin e kërkesëpadiës, duke kërkuar që paditësi të kompenzohet për kualifikimin nga data 11.11.2018 deri më datë 31.12.2021 sipas pagës së diferencës të përlllogaritur sipas pagës 459 paga bazë $459.95 \text{ €} * 35\%$ i pagës bazë (160.98 € - 82.55 diferencë e paguar në page = 78.43 €) x 38 muaj gjithsej $38 * 78.43 = 2,980.34 \text{ €}$. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro në emër të taksës shumë prej 20 euro dhe për përpilimin e precizimit shumë prej 104.00 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes avokaturës shtetërore me datë 29.03.2024 ka parashtruar përgjigje në padi, ndër të tjera ka theksuar duke e kontestuar kërkesëpadinë, paditësit si të pa themelët, nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në bazë të vërtetimit, kërkespadija e paditësit është e mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit të vitit 2017 nr.2056 në kuptim të nenit 7, e paditura vlerëson se në këtë qështje juridike kemi të bëjmë me paditësin i cili ka themeluar marrëdhënien e punës si i diplomuar, mbështetur në nenin 78 të Ligjit të Punës përcaktohet se i punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston për realizimin e të drejtave të shkelura, në bazë të ligjit të punës është përcaktuar afati i parashkrimit të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit si e pa themelë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qellim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: Kontratën e Punës nr.319/3 të datës 07.12.2016, Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.55/1 të datës 30.04.2021, Vërtetimin nr.113/1 të datës 20.08.2021, Diplomën nr.1673 të datës 10.05.2007, Diplomën Mastër nr.283 të datës 01.02.2014, licencën e mësimdhënësit nr...., Vërtetimin mbi përvojën e punës nr. 661/4 të datës 08.11.2022 dhe Listën e Pagave.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në punë dhe detyra të punës mësimdhënës në Qendrën e Kompetencës “K.K.” në Malishevë, ndërsa kontestues mes palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë e drejta në kompenzimin e plotë në emër të licencimit/kualifikimit, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas neni 7 par 1 përcaktohet se *“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi...”* kjo gjykatë vlerëson se paditësit i takon e drejta e kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit, gjykata u bazua në diplomën e kualifikimit të paditësit dhe kontratën e punës.

Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/23 të datës 29.08.2008 në pikën 4 përcaktohet se *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%, me diplomë, me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 % dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”* ndërsa nga Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të nxjerrë nga seanca e përgjithshme i datës 09.10.2023 GJ.A-SU 214/2023 i cili derivon nga vendimi i Qeverisë së Kosovës në pikën I përcaktohet se *“Për kërkesat e mësimdhënësve për kompenzimin mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushtëve dhe kriterëve të përcaktuara me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/23 të datës 29.08.2008,”* kjo gjykatë vlerëson se mbi bazën e Kontratës Kolektive- Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës paditëseve i takon e drejta e kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, poashtu sa i përket të drejtës në kompenzimin e mjetëve në emër të licencimit/kualifikimit, gjykata u bazua në diplomatën e kualifikimit të paditësve, licencimin dhe kontratën e punës.

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”* ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se *“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”*, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompenzimin mbi

bazën e kualifikimit/licencimit gjykata vendosi sipas përiudhës nga viti 2018 deri në vitin 2021 periudhe në të cilën ishte në fuqi kontrata kolektive paraprake nr.0113/2056 dt.18.04.2017, në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësve, por gjykata pretendimet e e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase paditësi padinë e ka parashtruar në përiudhën në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, gjegjësisht Kontrata Kolektive e datës 18.04.2017, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja padinë e ka parashtruar në të njëjtën periudhë që përkon me kontratën kolektive të vitit 2017 dhe të vitit 2021, e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohen se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Gjykata kishte parasysh edhe pretendimet tjera të të paditurës mirëpo vlerëon se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe.

Gjykata përmes listës së pagave ka vërtetuar se paditësi ka pagën bazë 459.00 euro, ndërsa nuk qëndron pretendimi se i njëjti ka pagën bazë 459.95 euro siç pretendohet në padi, andaj sipas listës së pagave paga bazë 459.00 € x 35% e pagës bazë = 160.65 euro- 82.55 diferencë e paguar në page = 78.10 €) x 38 muaj gjithsej 38* 78.10 = 2,967.80 €, andaj gjykata refuzoj shumën prej 12.54 euro mbi këtë bazë dhe vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashkrimit të padisë (11.11.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 453.1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”* dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, ashtu që vendosi që paditësve t'ua njoh shpenzimet e procedurës duke detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguajë shumën prej 104.00 euro në emër të parashkrimit të padisë dhe shumën prej 20.00 euro në emër të taksës gjyqësore, ndërsa e refuzoi shumën prej 104.00 euro të kërkuar në emër të shpenzimeve për precizimin e kërkesëpadisë.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 të LPK-së si dhe nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës lidhur me nenin 35 dhe 7 e Kontratës Kolektive Arsimit.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni civil

C.nr.1056/21 me datën 20.08.2024

Gj y q t a r j a

Hatixhe Begaj

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.